

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i Specializuar i Hashim Thaçit

Data: 17 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtja e Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqi

Venkatesvari Alagendra

I. HYRJE

1. Më 31 gusht 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve.¹
2. Në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake trajtoi kundërshtimet e ngritura në dy prej mocioneve paraprake të z. Thaçi, lidhur me përputhshmërinë mes disa elementeve qendrore të kornizës së Dhomave të Specializuara të Kosovës ("DHSK") dhe kufizimeve kushtetuese në fuqi dhe mbi të drejtat themelore të të akuzuarve të cilat gëzon z. Thaçi.²
3. Krahas rrëzimit të parashtrimeve të Mbrojtjes, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu pohoi se këto kundërshtime nuk mund të konsideroheshin "juridiksionale" në thelb, pasi nuk u përkisnin katër "kategorive tradicionale" të juridiksionit, që janë "lëndor, kohor, territorial dhe personal".³ Në këtë mënyrë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake pretendoi t'i trajtonte kundërshtimet jo në bazë të rregullës 97(1)(a) të Rregullores,⁴ por në pajtim me nenin 39(1) të Ligjit të DHSK-së.⁵ Për këtë arsye, e drejta për apel nuk është e vetvetishme, por duhet marrë leje.
4. Duke rezervuar të drejtën e z. Thaçi lidhur me llojin e kundërshtimeve, në pajtim me rregullën 77 të Rregullores dhe nenin 45 të Ligjit të DHSK-së, Mbrojtja e z.

¹ KSC-BC-2020-06/F00450, Vendim mbi Mocionet që Ngrënë Kundërshtime ndaj Ligjshmërisë së DHS-së dhe ZPS-së dhe Shkeljen e Pretenduar të Disa të Drejtave Kushtetuese të të Akuzuarve, 31 gusht 2021 ("Vendimi i Kundërshtuar").

² KSC-BC-2020-06/F00216, Mocion Paraprak për Rrëzimin e Aktakuzës për Shkak të Mungesës së Juridiksionit, 12 mars 2021 ("Mocioni i Thaçit mbi Juridiksionin"); KSC-BC-2020-06/F00217, Mocion që Kundërshton Juridiksionin mbi Bazën e Shkeljes së të Drejtave Themelore të Mishëruara në Kushtetutë, 12 mars 2021 ("Mocioni Paraprak i Thaçit mbi të Drejtat Themelore").

³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 54.

⁴ Rregullorja e Procedurës dhe e Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja").

⁵ Ligji nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji i DHSK-së"); Vendimi i Kundërshtuar, para. 55.

Thaçi (“Mbroytja”) kërkon leje për apelimin e Vendimit të Kundërshtuar lidhur me tetë pikat e apelueshme të paraqitura më poshtë. Secila prej tyre përmbush kriteret për leje, gjë që përlligj shqyrtimin nga Dhoma e Apelit.

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

5. Neni 45(2) i Ligjit të DHSK-së përcakton, në pjesën përkatëse, se Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen në rastet kur apeli:

“përfshin një çështje e cila do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin e drejtë dhe të shpejtë të procedurave ose në rezultatin e shqyrtimit gjyqësor dhe për të cilën, sipas mendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake ose të trupit gjykues, zgjidhja e menjëhershme nga ndonjë Panel i Gjykatës së Apelit mund ta avancojë materialisht procedurën.”

6. Rregulla 77(2) e Rregullores përcakton se:

“Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një çështje që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes që gjykohet dhe për të cilën, një vendim i menjëhershëm nga ana e panelit të Gjykatës së Apelit mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor.”

7. Rrjedhimisht, zbatohen kriteret e posaçme në vijim, që janë konfirmuar nga jurisprudenca e DHSK-së:

(a) Nëse pika e ngritur përbën “pikë të apelueshme”;

(b) Nëse pika në fjalë do të ndikonte ndjeshëm në:

(i) kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose

(ii) rezultatin e gjykimit; dhe

(c) Nëse, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake, një vendim i menjëhershëm i Dhomës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.⁶

⁶ KSC-BC-2020-07/F00169, Vendim mbi Kërkesat e Mbroytjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbroytjes, 1 prill 2021 (“Vendimi mbi Lejen për Apelim të Guccatit dhe

8. “Pika” është “një temë ose lëndë e identifikueshme, zgjidhja e së cilës është kyçe për marrjen e vendimit mbi problemet që dalin në çështjen gjyqësore që shqyrtohet, dhe jo thjesht një temë për të cilën ka mospajtime ose mendime të kundërta.”⁷ Parashtruesi i kërkesës duhet të shprehë “qartë secilën prej pikave të veçanta që shtron për zgjidhje para Panelit të Gjykatës së Apelit, të cilat burojnë nga vendimi në fjalë dhe nuk përbëjnë tema abstrakte apo shqetësime hipotetike.”⁸

9. Miratimi nuk ka të bëjë me atë nëse një vendim është arsyetuar drejt, por nëse është përmbushur standardi i miratimit.⁹

III. PIKAT E PROPOZUARA PËR APEL

10. Kërkohet leje për apelimin e pikave të mëposhtme (“Pika” ose bashkërisht “Pikat”), të cilat përmbushin kriteret e nenit 45(2) të Ligjit të DHSK-së dhe të rregullës 77(2) të Rregullores:

Pika 1: Nëse cenohet konstatimi i Gjykatësit të Procedurës Paraprake se *nuk* ka përfunduar mandati kohor i DHSK-së dhe ZPS-së¹⁰, për shkak të mosshqyrtimit ose mosdhënies së arsytimit ose arsytimit të mjaftueshëm në lidhje me (i) synimin legjislativ të Kuvendit; (ii) Amendamentin e propozuar Kushtetues nr. 26; (iii) faktin se njoftimi i nenit 162(14) është i zbatueshëm vetëm për një mandat kohor *minimal*; dhe (iv) faktin se kalimi i sovranitetit në pajtim me

Haradinajt”), para. 6; KSC-BC-2020-06/F00172, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel, 11 janar 2021 (“Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit”), para. 10.

⁷ Vendimi mbi Lejen për Apelim të Gucatit dhe Haradinajt, para. 12; Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 11.

⁸ Po aty.

⁹ Vendimi mbi Lejen për Apelim të Gucatit dhe Haradinajt, para. 18; Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 17.

¹⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 65-68.

nenin 20 të Kushtetutës¹¹ nuk duhet të jetë pa afat, i papërcaktuar dhe i njëanshëm.¹²

Pika 2: Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në konstatimin se për çështjen e mandatit kohor të DHSK-së ishte “marrë vendim nga DHSGJK-ja”¹³, pa dhënë arsytim apo arsytim të mjaftueshëm, dhe në një mënyrë që nuk përputhet me nenet 113(7) dhe 144(3) të Kushtetutës, të cilat Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk i ka marrë aspak parasysh.

Pika 3: Lidhur me faktin nëse hetimi i ZPS-së kishte bazë ligjore apo kushtetuese, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke i bazuar konstatimet e tij në mënyrë të pasaktë në vlerësimin nëse neni 159(1) i KPPK-së¹⁴ ishte përfshirë shprehimisht në Ligjin e DHSK-së,¹⁵ në vend që të ndiqte si duhet aspektin e zbatueshmërisë së KPPK-së në rastet kur nuk trajtohet në Ligjin e DHSK-së dhe në Rregullore, dhe duke mos marrë parasysh parashtrimet e Mbrojtjes mbi Shkëmbimin e Letrave.¹⁶

Pika 4: Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke hedhur poshtë parashtrimet e Mbrojtjes se Ligji i DHSK-së kishte krijuar një “gjykatë të jashtëzakonshme”, thjesht duke u bazuar në një konstatim të mëparshëm se DHSK-ja ishte krijuar me ligj,¹⁷ rrjedhimisht duke mos trajtuar thelbin e argumenteve të Mbrojtjes.¹⁸

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (“Kushtetuta”).

¹² Mocioni i Thaçit mbi Juridiksionin, para. 44-52. Shih gjithashtu KSC-BC-2020-06/F00304, Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes së Prokurorisë për Mocionet Paraprake në lidhje me Raportin e Këshillit të Evropës, Afatin e Hetimit dhe Mandatin Kohor, 14 maj 2021, para. 29-30.

¹³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 67.

¹⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës 2012, Ligji nr. 04/L-123 (“KPPK”).

¹⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 73-77.

¹⁶ Mocioni i Thaçit mbi Juridiksionin, para. 57 dhe poshtëshënimi. 74.

¹⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 113.

¹⁸ Mocioni i Thaçit mbi Juridiksionin, para. 36-43.

Pika 5: Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur nuk trajtoi apo nuk arsyetoi në mënyrë të mjaftueshme aspektet e ngritura nga Mbrojtja lidhur me të drejtën e z. Thaçi për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, duke u bazuar në mënyrë të gabuar në jurisprudencën e pazbatueshme të GJEDNJ-së,¹⁹ dhe duke mos marrë aspak parasysh se “**së bashku**, këto tipare të çojnë në përfundimin e pashmangshëm se nga pikëpamja strukturore DHSK-ja nuk përmbush kriteret e nenit 6(1) të KEDNJ-së”.²⁰

Pika 6: Nëse ishte e mundshme për një gjykatës të arsyeshëm të procedurës paraprake të konstatonte se kriteri i pavarësisë dhe paanshmërisë nuk zbatohet për të kufizuar ndërhyrjen ndaj Prokurorit të Specializuar,²¹ sidomos duke pasur parasysh se një gjë e tillë bie ndesh me nenin 109(1) dhe (2) të Kushtetutës.

Pika 7: Sa i përket së drejtës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi duke konstatuar se periudha relevante filloi vetëm më 17 nëntor 2019, bazuar në interpretimin e gabuar e kufizues të jurisprudencës përkatëse të GJEDNJ-së.²²

Pika 8: Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi në vlerësimin e shkeljes së prezumimit të pafajësisë së z. Thaçi në kuadrin e vetë Raportit të Martit,²³ duke mos trajtuar parashtrimet e Mbrojtjes se kjo shkelje buron nga mënyra se si DHSK-ja e përkufizon veten në lidhje me një raport i cili e dënon të akuzuarin, dhe nga bekimi që DHSK-ja dhe ZPS-ja i kanë dhënë këtij raporti.²⁴

¹⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 101.

²⁰ Mocioni Paraprak i Thaçit mbi të Drejtat Themelore, para. 49 (theksimi i shtuar). Shih gjithashtu, para. 36-51.

²¹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 108.

²² Vendimi i Kundërshtuar, para. 123-130.

²³ Vendimi i Kundërshtuar, para. 136-142.

²⁴ Mocioni Paraprak i Thaçit mbi të Drejtat Themelore, para. 34, 35.

IV. PARASHTRIMET: PËRMBUSHET STANDARDI PËR MIRATIMIN E LEJES

A. PIKAT JANË TË APELUESHME

11. Tetë Pikat e identifikuara janë të apelueshme pasi burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar dhe kundërshtojnë konstatime konkrete të tij.²⁵ Këto Pika nuk shprehin thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar, as përbëjnë tema abstrakte apo shqetësime hipotetike. Përkundrazi, Mbrojtja ka artikuluar gabime të ndryshme dhe konkrete në arsyetim ose juridike, vendimi për të cilat është thelbësor për përcaktimin e aspekteve të lëndës gjyqësore që shqyrtohet, që janë përputhshmëria e elementeve qendrore të kornizës së DHSK-së me kufizimet kushtetuese në fuqi, si dhe të drejtat themelore të të akuzuarit të cilat gëzon z. Thaçi.

B. PIKAT NDIKOJNË NDJESHËM NË 1) KRYERJEN E DREJTË DHE TË SHPEJTË TË PROCESIT OSE 2) REZULTATIN E GJYKIMIT

12. Pikat e identifikuara në kërkesën aktuale për leje janë thelbësore sa i përket drejtësisë dhe legjitimitetit të procesit të DHSK-së. Ndërkohë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka konstatuar më parë se apelet e ndërmjetme që ndërpresin vijimësinë e procesit janë përjashtim,²⁶ pikat paraprake të identifikuara në apelin aktual trajtojnë aspekte qendrore të legjitimitetit, ligjshmërisë, mandatit dhe drejtësisë së institucionit dhe procesit të tij, dhe, për pasojë, janë plotësisht brenda kuadrit të nenit 45(2) të Ligjit të DHSK-së dhe rregullës 77(2) të Rregullores.

13. Konkretisht, në rast se Ligji i DHSK-së krijoi vërtet një gjykatë të jashtëzakonshme, e cila aktualisht funksionon në bazë të një mandati të përfunduar, ky fakt nuk mund të ndahet nga aspektet e drejtësisë, shpejtësisë dhe rezultatit, dhe

²⁵ *Shih* më lart para. 10.

²⁶ Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 9.

përligj shqyrtimin përmes apelit. Në rast se hetimi dhe procesi vijues nuk kanë bazë ligjore ose kushtetuese, ose zhvillohen në një mënyrë që nuk respekton të drejtat themelore si e drejta për proces të shpejtë ose e respektimit të prezumimit të pafajësisë, atëherë, për të njëjtat arsye, përligjet shqyrtimi i këtyre pikave në apel. Ndërkohë që nuk parashtrohet se mjafton vetëm natyra thelbësore e këtyre aspekteve për miratimin e lejes,²⁷ Pikat e ngritura në këtë rast janë të tilla sa që një vendim i ndryshëm do të ndikonte *ndjeshëm* jo vetëm në drejtësinë dhe shpejtësinë e procesit, por edhe lidhur me mbajtjen apo jo të këtyre gjykimeve.

14. Konkretisht, sa u përket **Pikave 1 dhe 2**, në rast se vërtet ka përfunduar mandati kohor i DHSK-së dhe ZPS-së, atëherë nuk ka bazë ligjore ose kushtetuese për këtë procese gjyqësore, gjë që jo vetëm pamundëson kryerjen e një procesi të drejtë dhe të shpejtë por edhe nënkupton se gjykimet nuk mund të zhvillohen dhe, rrjedhimisht, ndikohet *ndjeshëm* në rezultatin e tyre. Në mënyrë të ngjashme, sa i përket bazës ligjore dhe kushtetuese të hetimit të ZPS-së, që ngrihet në **Pikën 3**, në rast se ZPS-ja nuk kishte të drejtë ta hetonte sërish çështjen gjyqësore, por ishte krijuar në fakt për organizimin e “procedurave të gjykimit dhe apelit që do të dilnin nga hetimi i TFHS-së” siç përcaktohet nga Shkëmbimi i Letrave, atëherë ndikohen *ndjeshëm* drejtësia, shpejtësia dhe rezultati.

15. Sa u përket **Pikave 4 dhe 5**, në thelb të Mocionit Paraparak të Thaçit mbi të Drejtat Themelore ishte analiza e strukturës dhe funksionimit të DHSK-së, vlerësuar në kuadrin e së drejtës së z. Thaçi për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj. Mbrojtja ka paraqitur argumente të gjerësishme në mbështetje të parashtrimit se Ligji i DHSK-së krijoi një gjykatë të jashtëzakonshme,²⁸

²⁷ Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 9: “Argumentet se një apel i ndërmjetëm do të trajtonte çështje themelore ose do të ishte i dobishëm për Dhomat e Specializuara në vetvete nuk përligjin miratimin e lejes për apel”.

²⁸ Mocioni Paraparak i Thaçit mbi të Drejtat Themelore, para. 36-46.

e cila nuk garanton pavarësi dhe paanshmëri, në kushtet e mungesës së legjislacionit të duhur për mbrojtjen e këtyre garancive.²⁹ Gjithashtu, janë paraqitur shtatë tregues konkretë të pamundësisë së DHSK-së për të funksionuar plotësisht në mënyrë të pavarur, pa kufizime apo vartësi.³⁰ **Pika 6** identifikon gabime juridike dhe në arsyetim në gjykimin e parashtrimeve të Mbrojtjes nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake, të cilat natyrisht që ndikojnë ndjeshëm në drejtësinë dhe shpejtësinë e çdo procesi që zhvillon DHSK-ja kundër të akuzuarit, si dhe në rezultatin e gjykimit.

16. **Pikat 7 dhe 8** kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me drejtësinë dhe shpejtësinë, pasi përqendrohen vetëm në gabimet gjatë gjykimit të kundërshtimeve ndaj pretendimeve të shkeljes së të drejtave për gjykim të drejtë – të cilat janë prezumimi i pafajësisë dhe e drejta e gjykimit pa vonesa të papërligjura. Rrjedhimisht, vetëkuptohet që Pikat 7 dhe 8 do të ndikonin ndjeshëm në zhvillimin e një procesi të drejtë dhe të shpejtë. Gjithashtu, në rast se procesi zhvillohet në një mënyrë që faktikisht i shkel këto të drejta, çdo mjet juridik për trajtimin e këtyre shkeljeve do të ndikonte ndjeshëm në rezultatin e çdo gjykimi të mëpasshëm.

17. Për rrjedhojë, të gjitha Pikat e identifikuara në kërkesën aktuale për leje për apelim përmbushin kriterin e parë dhe të dytë në lidhje me ndikimin e tyre të ndjeshëm në zhvillimin e një procesi të drejtë dhe të shpejtë, dhe në rezultatin e gjykimit.

C. NJË VENDIM I MENJËHERSHËM I PANELIT TË DHOMËS SË APELIT MUND TË KONTRIBUOJË THELBËSISHT NË PROCESIN GJYQËSOR

18. Elementi i dytë i standardit të miratimit kërkon që të provohet se referimi i menjëhershëm i një pike për apelim Panelit të Gjykatës së Apelit do ta zgjidhë

²⁹ Mocioni Paraprak i Thaçit mbi të Drejtat Themelore, para. 47.

³⁰ Mocioni Paraprak i Thaçit mbi të Drejtat Themelore, para. 48-51.

problemin dhe çlirojë “procesin gjyqësor nga gabimet e mundshme që, ose mund të njollosin drejtësinë e procesit, ose mund të dëmtojnë rezultatin e gjykimit”, duke mundësuar kështu mbarëvajtjen e duhur të procesit.³¹

19. Të gjitha Pikat e identifikuara në apelin aktual përmbushin kriterin e elementit të dytë. Vendimi për secilën prej këtyre Pikave mund të kontribuojë thelbësisht në procesin gjyqësor duke dhënë garanci ligjore lidhur me përputhshmërinë e elementeve qendrore të kornizës së DHSK-së me kufizimet kushtetuese në fuqi, dhe të drejtat themelore të të akuzuarit të cilat gëzon z. Thaçi. Këto janë Pika të cilat, për nga vetë natyra e tyre, kërkojnë vendim të menjëhershëm duke pasur parasysh se kanë mundësi të njollosin drejtësinë ose të dëmtojnë rezultatin e gjykimit. Gjithashtu, përcaktimi i tyre në fazën para gjykimit do të ulte vonesat që rrjedhin nga shqyrtimi i sërishëm juridik apo nga paqartësia e vazhdueshme procedurale. Në këtë mënyrë, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Apelit lidhur me tetë Pikat do të kontribuonte thelbësisht në procesin gjyqësor,³² që nënkupton se janë përmbushur kriteret për leje për apelim.

V. MJETI JURIDIK QË KËRKOHET

20. Për arsytet e lartpërmendura, Mbrojtja i kërkon me respekt Gjykatësit të Procedurës Paraprake të miratojë lejen për apelimin e Pikave në pajtim me nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2).

[Numri i fjalëve (në origjinal): 2478 fjalë]

³¹ Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 16.

³² *Shih*, Vendimin mbi Lejen për Apelim të Guçatit dhe Hardinajt, para. 32; ICTR, *Prosecutor v. Uwinkindi*, ICTR-01-75-PT, Decision on Defence Application for Certification to Appeal Decision on Preliminary Motion Alleging Defects on the Form of the Amended Indictment, 28 March 2011, para. 10.

Parashtruar me respekt,

/nënshkrimi/

Gregori W. Kihou

Mbrojtës i Hashim Thaçit

E premte, 17 shtator 2021

Tampa, Shtetet e Bashkuara